

Takim i përbashkët pune lidhur me drejtësinë penale të të miturve në Shqipëri

Në datën 02 tetor 2023 në Rezidencën e Ambasadës së Francës, u zhvillua takimi për ndarjen e gjetjeve dhe rekomandimeve të raportit hartuar me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë Franceze në kuadër të *“Drejtësisë së të miturve në Shqipëri”*.

Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, mori pjesë në këtë takim në cilësinë e ministrisë përgjegjëse për hartimin dhe monitorimin e politikave në fushën e drejtësisë, ku mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të të miturve është një ndër prioritetet kyçe të institucionit tonë, e jetësuar në Programin e Qeverisë Shqiptare nën objektivin madhor: *“Zbatimi i reformimit të sistemit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin, duke forcuar sistemin e drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive procedurale”*.

Në këtë takim u diskutua rreth arritjeve në fushën e drejtësisë për të mitur si dhe për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve që punojnë me dhe për të miturit, duke sjellë dhe ndarë eksperiencat më të mira në këtë fushë.

